


Aktiviteti Bankar

Dr. Elvin MEKA

4₍₂₎

Pasivet e bankës



Depozita bankare

Bankingu është një biznes që përdor gjerësisht levën financiare (financohet me fonde të huajtura në shkallë të gjerë) dhe pak kapital aksioner.

Dallimi midis bankingut dhe bizneseve të tjera qëndron në faktin se, depozitat dhe fondet e huajtura nuk konsiderohen si një burim i jashtëm financimi, por janë pjesë integrale e biznesit bankar.

Depozita mund të shihet si:

- Investim që përfiton një të ardhur,**
- Hua që i akordohet bankës.**

Depozita bankare

Depozitat mund të klasifikohen si:

- **Depozita të individëve (retail) dhe në shuma të vogla,**
- **Depozita të bizneseve (wholesale) dhe në shuma të mëdha.**

Depozita bankare

Depozitat RETAIL:

- **Çmimi u caktohet nga bankat (pricetakers),**
- **Nuk kanë shumë qarkullim dhe karakterizohen nga inertësia (kostot e zhvendosjes),**
- **Të pandjeshme nga diferencat në çmime (ndjeshmëria varet nga shuma dhe qëllimi i krijimit të depozitës),**
- **Lidhen ngushtësisht me pozicionin fizik të bankës (dhe degëve të saj) dhe lehtësive që ajo ofron në përdorimin e infrastrukturës së saj.**
- **Kosto të larta administrative.**

Depozita bankare

Depozitat WHOLESALE:

- **Çmimi vendoset nga kërkesë-oferta (negociohen),**
- **Shumë të qarkullueshme,**
- **Tepër të ndjeshme ndaj diferencave në çmime,**
- **Lidhen ngushtësisht me cilësinë dhe besueshmërinë e bankës,**
- **Kosto të ulta administrative për njësi fondesh.**

Depozita bankare

Natyra e kontratave të depozitave:

Depozitat mund të kenë afat maturimi:

- të fiksuar (si çertifikatat e depozitave) ose
- të pacaktuar (të tërheqshme në çdo kohë).

Depozita pa afat është një nga detyrimet kryesore të bankave. Ajo përmban 4 elementë themelorë:

- 1. Maturimi i saj nuk ka kufij kohorë, e mund të rivendoset pafundësisht,**
- 2. Përfaqëson një kontratë detyrimi (borxhi),**
- 3. Nuk tregtohet në tregun sekondar,**
- 4. Përmban kufizimin e «shërbimit sekuencial».**

Depozita bankare

Natyra e kontratave të depozitave:

Maturimi:

I garanton depozituesit të drejtën për të tërhequr fondet e tij në çdo kohë, duke ia shitur mbrapsht bankës detyrimin e saj me vlerë nominale.

Depozita pa afat është pothuaj likuide sa paraja e gatshme (*cash*), por dallon prej saj, pasi depozita mbart rrezikun e dështimit të bankës.

Depozita bankare

Natyra e kontratave të depozitave:

Kontratë detyrimi (borxhi):

Depozita e klientit është një borxh (detyrim) i bankës.

Depozituesi ndeshet me dëmin moral të zëvendësimit të aktiveve nga ana e bankës kur i depozition fondet me të (banka mund t'i përdorë fondet e tij për blerje të aktiveve jofitimprurëse apo me rrezik të lartë, duke rritur përfitimet e aksionerëve në dëm të depozituesve).

Depozita bankare

Natyra e kontratave të depozitave:

Kontratë detyrimi (borxhi) e patregtueshme:

Kthimi nga depozita e klientit të bankës nuk varet nga informacioni mbi bankën që përpunojnë pjesëmarrësit në treg; depozituesi nuk ndeshet me rrezikun e luhajtjeve të çmimit të tregut.

Depozitesi e ka të qartë sasinë e fondeve (në vlerë nominale) që do të përfitojë në një datë të caktuar në të ardhmen (me kusht që banka të jetë solvente).

Depozita bankare

Natyra e kontratave të depozitave:

Kufizimi i «shërbimit sekuencial»:

Bankat i paguajnë (shlyejnë) depozituesit e tyre sipas parimit «i pari në rradhë paguhet i pari».

Banka shlyen detyrimin e depozituesit në përputhje me detyrimin kontraktual dhe sipas rradhës së paraqitjes së tyre në sportel.

Depozita bankare

Natyra e kontratave të depozitave:

- **Kushtëzon manaxhimin e bankës të jetë tepër i kujdesshëm me administrimin efektiv të fondeve të depozituara,**
- **Shmang dhe kufizon dëmin e trefishtë moral:**
 - 1. Investimin në aktive me shumë rrezik,**
 - 2. Monitorimin e dobët të huamarrësve,**
 - 3. Shpërdorimin e fondeve të depozituesve dhe përdorimin e tyre për qëllime e përfitime personale e nepotike.**

Depozita bankare

Depozitat pa afat mund të klasifikohen:

- 1. Depozita bazë ose kryesore (primary or passively created),***
- 2. Depozita të prejardhura (derivative or actively created)***

Depozita bankare

***Depozita bazë ose kryesore* (primary or passively created):**

Përfaqësohet nga fondet që depozitojnë klientët në bankë.

Banka nuk mund të përcaktojë madhësinë e tyre kështu që, këto depozita krijohen pasivisht dhe jashtë vullnetit të bankës.

Këto depozita konvertojnë paranë e gatshme të klientëve në depozita bankare.

Depozita bankare

Depozita të prejardhura (actively created):

Janë depozita që krijohen nga bankat nëpërmjet procesit të krijimit të pretendimeve financiare nga ata e tyre (në formën e huave bankare apo blerjeve të letrave me vlerë ose mjeteve dhe aktiveve të tjera).

Këto depozita:

- quhen sekondare pasi krijimi i tyre mbështetet në depozitat kryesore (primare),**
- rrisin totalin e stokut të parave të publikut).**

Depozita bankare



Depozita bankare

Produktet konkurruese të depozitave bankare:

- 1. Investimet në tregjet e aksioneve,**
- 2. Investimet në fondet e investimeve,**
- 3. Titujt qeveritarë (qendrorë dhe vendorë),**
- 4. Obligacionet e shoqërive aksionere,**
- 5. Produktet e investimit të shoqërive të sigurimit,**
- 6. Investimet në fondet afatshkurtra të investimit (money market funds).**

Manaxhimi i Detyrimeve

Depozitat bankare dhe manaxhimi i tyre janë elementi kryesor në manaxhimin e detyrimeve.

Bankat i kushtojnë vëmendje të madhe përlllogaritjes së *MARZHIT I INTERESIT NETO* (NIM – Net Interest Margin):

$$NIM = \frac{(Te\ ardhurat\ nga\ interesat - Shpenzimet\ per\ interesa)}{Totali\ i\ Aktiveve}$$

Manaxhimi i Detyrimeve

Manaxhimi i detyrimeve fokusohet në 3 aspekte:

- 1. Diversifikimi (krijimi i burimeve të ndryshme të financimit të aktivitetit bankar),**
- 2. Kompozimi i depozitave (depozita dhe produkte depozitash me natyra dhe karakteristika të ndryshme),**
- 3. Struktura e maturimit (përdorimi produkteve derivate).**

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Zërat jashtë bilancit janë detyrime potenciale, të marra përsipër nga banka, që mund të kthehen në detyrime aktuale, sipas disa kushteve të caktuara.

Zërat jashtë bilancit përfshijnë ekspozime si:

- Angazhimet për huatë,**
- Letërhuatë mbështetëse,**
- Swap-et për normat e interesit dhe valutat,**
- Kontratat derivate (opsione, futures).**

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Zërat jashtë bilancit u rritën shumë gjatë viteve '70 dhe '80 gjatë së cilës bota përjetoj një situatë me norma shumë të luhatshme interesi.

Shoqëritë shumëkombëshe janë klientët më të mëdhenj të bankave për instrumente e shërbime që lidhen me manaxhimin e rrezikut të normës së interesit.

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Klasifikimi i zërave jashtë bilancit:

Klasifikimi i zërave	Zërat
Pretendime kontigjencë të ngjashme me opsionet	1) Angazhimet dhe Garancitë për huatë
	2) Opsionet
	3) Letërhuatë mbështetëse
Pretendime kontigjencë jo opsionale	1) Swap-s të normave të interesit
	2) Transaksione me valutat me shlyerje të mvonshme
	3) Kontratat FUTURES dhe FORWARD

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Angazhimet për huatë:

Shumica e huave (në SHBA) akordohen në formën e angazhimeve për huatë (loan commitments).

Sipas përdorimit:

- **Ndërtim dhe zhvillim territori,**
- **Financim shkrirjesh dhe bashkimesh (mergers & acquisitions, M&A)**
- **Blerje shoqërisht nëpërmjet levës financiare (Leveraged buyouts, LBO),**
- **Linjat mbështetëse të huasë për letrat tregtare.**

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Angazhimet për huatë:

Sipas garancive për normën e interesit:

- **Angazhime me normë fikse,**
- **Angazhime me normë të ndryshueshme (ose me formulë fikse):**
 - ***Shtuese,***
 - ***Shumëfishuese***

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Angazhimet për huatë:


Bankat mund dhe të mos e respektojnë angazhimin e marrë për huatë, duke përdorur klauzolën: «Material Adverse Change (MAC)».

Kjo klauzolë është standarde në të gjithë kontratat e angazhimeve për huatë.

Kjo klauzore i jep të drejtë bankës të mos respektojë angazhimin e marrë, nëse pozita financiare e huamarrësit përkeqësohet thelbësisht, që nga momenti i marrjes së angazhimit nga banka deri në momentin e kërkesës nga ana e huamarrësit për ushtrimin e opsionit të angazhimit për huanë.

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Angazhimet për huatë:



Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Arsyet e përdorimit të angazhimeve për huatë:

Bankat:

- (a) Shmangia e ngarkesave rregullatore (gjenerimi i komisioneve pa nevojën e kapitalit shtesë dhe shmangia e rezervës së detyrueshme),**
- (b) Reputacioni dhe Kompetenca Kontraktuale (kompromisi midis kapitalit financiar dhe reputacionit)**
- (c) Parashikimi i kërkesës në të ardhmen.**

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Arsyet e përdorimit të angazhimeve për huatë:

Klientët:

- (a) Ndarja e rreziqeve me bankën (angazhime me norma fikse ose të ndryshueshme sipas profilit të rrezikut të klientit, ku në çdo rast bankës i transferohet një pjesë e rrezikut),**
- (b) Kufizimi i dëmit moral (ofrimi i angazhimeve për huatë me normë më të ulët interesi, por që kompensohet nga komisionet për angazhimet rspektive)**
- (c) Garanci likuiditeti për kreditorët (furnitorët).**

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Arsyet e përdorimit të angazhimeve për huatë:

Klientët:

- d) Mbrojtje kundrejt racionimit të kredisë në të ardhmen (nga rënia e besueshmërisë së klientit, kufizimi i kreditimit në ekonomi, ulja e aftësisë kredituese të bankës),**
- e) Evitimi i mungesave në treg (mungesa e instrumenteve që evtojnë rrezikun mundëson përdorimin e angazhimeve për huatë).**

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Rreziqet qe shoqërojnë angazhimet për huatë:

- a) Rreziku i ofrimit të huave me interesa të ulta,**
- b) Ofrimi i huave për huamarrësit me profil të lartë rreziku,**
- c) Respektimi i angazhimeve gjatë periudhave me likuiditet të pakët**

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Letër kreditë:

Marrje përsipër e detyrimit për pagesë nga ana e bankës në favor të një klienti të saj të pagesave të adhshme që rrjedhin nga tregtia ndërkombëtare.

Letër kreditë mbështetëse:


Nuk nënkupton domosdoshmërisht financimin e transaksionit të tregtisë ndërkombëtare. Pagesa bëhet e detyrueshme nëse klienti i bankës nuk paguan.

Aktiviteti Bankar

4(2)

Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)


Letër kreditë:



Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

SWAPS:

Marëveshje midis dy palëve për shkëmbim midis tyre të ekspozimeve ndaj rreziqeve të caktuara.



Zërat jashtë bilancit (off-balance sheet items)

Produktet derivatë për besueshmërinë (credit derivatives):

Një lloj opsioni për shitje (put option) që huadhënësi blen nga një palë e tretë dhe që garanton pagesat në rast të paaftësisë paguese të huamarrësit për huanë që ky ka marrë nga huadhënësi në fjalë.

Titullizimi (Securitization)

Një teknikë financiare e filluar gjatë viteve '70 nga Government National Mortgage Association, GNMA - GINNIE MAE - mbi bazën e hipotekave rezidenciale.

Konsiston kryesisht në nxjerrjen e kredive nga bilancet e institucioneve huadhënëse dhe grumbullimin e tyre në një fond të përbashkët, blerja e të cilit realizohet duke emetuar letra me vlerë (obligacione).

Pagesat e interesave dhe të principaleve për këto letra me vlerë derivojnë nga pagesat respektive ë huamarrësve.

Titullizimi (Securitization)


Procesi lidhet me transformimin e modelit të manaxhimit bankar nga origjinim-për-të-mbajtur në origjinim-për-të-shitur (transferuar).

Procesi konsiston në transformimin e aktiveve jolikuidie në aktive likuide (letra me vlerë).

Në procesin e titullizimit mund të kalojë çdo klasë huash:

- **Kredi hipotekore,**
- **Kredi për biznes,**
- **Kartat e kreditit,**
- **Hua për makina,**
- **Etj.**


Titullizimi (Securitization)



Aktiviteti Bankar

4(2)

Titullizimi (Securitization)



Titullizimi (Securitization)

Pjesa më e madhe përbëhet nga letrat me vlerë të kolateralizuara nga hipotekat për strehim (Residential Mortgage Backed Securities).


Pjesa tjetër e huave johipotekore përdoren si kolateral për të tjera letra me vlerë (Asset - Backed Securities).

Aktiviteti Bankar

4(2)

Titullizimi (Securitization)

Qarkullimi i fondeve nëpërmejt procesit të titullizimit:



Titullizimi (Securitization)

Llojet e titujve të kolateralizuar:

PASS THROUGHS

Tituj më të hershëm të krijuar. Nuk ofrojnë mbrojtje ndaj rrezikut të parapagimit të huave hipotekore.


PAY THROUGHS (CMO)

Titj më të vonshëm e modernë. Ofrojnë mbrojtje ndaj rrezikut të parapagimit, duke ndërtuar letra me vlerë në transhe të ndryshme në kohë me profil besueshmërie të ndryshëm.

Aktiviteti Bankar

4(2)

Titullizimi (Securitization)



Titullizimi (Securitization)

Avantazhet e titullizimit (bankat):

- **Sigurimi i një burimi të përhershëm likuiditeti, për vazhdimin e aktivitetit të kredidhënies,**
- **Manaxhim më i mirë i rrezikut të normës së interesit (ulje të afatit mesatar të maturimit të aktiveve ose rritje të afatit mesatar të detyrimeve),**
- **Evitimi i rrezikut të parapragimit të huave,**
- **Diversifikimi i burimeve të financimit,**
- **Kthim i lartë mbi kapitalin aksioner,**

Titullizimi (Securitization)

Avantazhet e titullizimit (bankat):

- **Fokusim të bankave në aktivitetet dhe shërbimet ku kanë specializim specifik (origjinim, monitorim dhe mbarëvjetje të procesit të kredisë),**
- **Shmangia e taksave të ndërmjetësimit:**
 - **Rezervat e detyrueshme,**
 - **Kapitali minimal,**
 - **Sigurimi i depozitave.**

Titullizimi (Securitization)

Avantazhet e titullizimit (investuesit):

- **Zvogëlim të efekteve të tregut të kufizuar të letrave me vlerë,**
- **Likuiditet dhe gjenerim të ardhurash më formë interesi mbi baza mujore.**

Titullizimi (Securitization)

Avantazhet e titullizimit (huamarrësit):

- **Kosto më e ulët huaje dhe**
- **Disponibilitet i qëndrueshëm kredidhënie.**